




Save the Children



Sweden
Sverige

SI MËSUAM DHE SA MËSUAM?

HOW DID WE LEARN AND HOW MUCH DID WE LEARN?



Prishtinë, 2020

Ky dokument është zhvilluar me mbështetjen e Save the Children dhe financim të Qeverisë Suedeze. Përgjegjësia për përmbajtjen qëndron tek zhvilluesi. Save the Children dhe Qeveria Suedeze jo-domosdoshmerisht ndajnë pikëpamjet dhe interpretimet e shprehura.

Organizimi i procesit mësimor në distancë/ virtual në kohë pandemie

Situata e pandemisë COVID-19 ka shkaktuar sfidë të veçantë në çdo segment të shoqërisë, përfshirë arsimin. Në mënyrë që të ndalet përhapja e virusit, institucionet arsimore gjithandej, përfshirë ato në Kosovë, janë detyruar të ndërpresin mësimin në të gjitha ambientet arsimore. Kjo situatë shtyu institucionet e arsimit të ri mendojnë për modalitete të reja dhe strategji alternative të organizimit të mësimin në distancë/ virtual, në mënyrë që të sigurohet vazhdimi i proceseve mësimore dhe angazhimi i nxënësve.

Në këtë rast përdorimi i teknologjisë u konsiderua si një nga komponentët kyçë dhe më e përshtatshme për të mbajtur funksional sistemin arsimor.

Kalimi nga mësimi në klasa në atë virtual ka qenë dhe vazhdon të mbetet sfidues si për mësimdhënësit ashtu edhe për nxënësit dhe prindërit e tyre.

Në Kosovë, në kushte të imponuara të pandemisë COVID-19, nga data 12 mars 2020, në bazë të udhëzimeve të Qeverisë së Republikës së Kosovës është ndërprerë mësimi nëpër shkolla dhe institucione të arsimit të lartë. Në përputhje me ligjet në fuqi, Ministria e Arsimit dhe Shkencës ka koordinuar përpjekjet për organizimin e mësimin në arsimin para universitar.

Bazuar në situatën e krijuar dhe sipas Ligjit (04/L-032) për Arsimin Para universitar në Republikën e Kosovës dhe në zbatim të vendimit 01/07 të datës 11.03.2020, MASH ka vendosur të fillojë mësimin në distancë në të gjitha institucionet arsimore të Republikës së Kosovës.

Realizmi i mësimin në distancë kishte për qëllim sigurimin e shërbimeve arsimore dhe realizimin e kurrikulës së Kosovës në përputhje me kushtet e krijuara në rrethana të pandemisë COVID – 19.

Bazuar në vendimin nr.01/07 të datës 11.03.2020 MASH ka ofruar instruksione dhe udhëzime për organizimin e mësimin në distancë për të gjithë fëmijët dhe nxënësit. Mësimi në distancë për klasat 1-9 është realizuar nëpërmjet transmetimit të mësimëve të regjistruara në televizionin publik (RTK), si dhe përmes kanalit të MASH-it në Youtube. Ndërsa në nivelin e mesëm të lartë mësimi në distancë është zhvilluar në mënyrë të decentralizuar, në nivel shkolle, ku mësimdhënësit ishin bartësit kryesor të mësimin në distancë. Po ashtu, janë hartuar udhëzime për mobilizimin e shkollave që t'u përshtaten kushteve të reja të punës, si dhe janë inkurajuar nisma të shkollave dhe të drejtorive komunale të arsimit për zbatimin e formave të tjera të mësimin në distancë, përfshirë organizimin e sesioneve online në kohë reale, përgatitjen e materialeve elektronike për mësim, kontrollimin e detyrave të nxënësve, dhënien e informatës kthyesë, komunikimin me familjen.

Për realizimin e mësimin në distancë janë përdorë platformat elektronike si: ZOOM, Google Meet, Google classroom, Facebook apo viber.

Përkundër organizimit të mësimit në distancë/ virtual përmes alternativave të ndryshme, ndërprerja e mësimit direkt në institucione arsimore parashihet të ketë pasoja mjaft serioze dhe afatgjata për ekonominë dhe shoqëritë, e që do të mund të ndikojnë në rritjen e pabarazive, mungesës së qasjes në shërbime arsimore të grupeve të cënueshme, përkeqësimi i gjendjes shëndetësore dhe kohezionit social.

Pavarësisht reagimit të shpejtë nga institucionet vendore për organizimin e mësimit në distancë/virtual humbjet në procesin e të nxënësve do të jenë të pashmangshme dhe të konsiderueshme, duke prekur në mënyrë të ndjeshme grupet e cënueshme, ku një pjesë e nxënësve janë në rrezik të humbjes së madhe të mësimit si pasojë e gjendjes shëndetësore, aftësisë së

kufizuar, kushteve dhe rrethanave në të cilat jetojnë e që mbase edhe do ta braktisin fare shkollën.

Ndërsa situata vazhdon të jetë e njëjtë sa i përket pandemisë dhe shkollat janë hapur e në disa vende pjesërisht, ofrimi i mësimit alternativ apo intensifikimi i mësimit në distancë dhe mbështetja për mësuesit dhe prindërit mund të pakësojë humbjet në procesin e të nxënësve.

Programet e përshpejtuara të të mësuarit për t'u kompensuar nxënësve humbjet në procesin e të nxënësve si dhe një buxhet i përshtatshëm për arsimin që të sigurojë kushte minimale për përballimin e kostove shtesë në periudhën e COVID-19, do të jenë thelbësore për të siguruar që nxënësit të kapin ritmin si dhe për të parandaluar pabarazi të mëtejshme.



Metodologjia e hulumtimit

Qëllimi i këtij hulumtimi është që të prezantojë dhe përshkruajë sfidat e nxënësve dhe prindërve që ndërlidhen me rrethanat e shkaktuara nga situata e pandemisë si dhe marrja e perspektivës së nxënësve dhe prindërve për mësimin në distancë/ virtual në periudhën mars-qershor 2020. Qëllimi është që të gjeturat e kësaj analize të ndahen me institucionet relevante arsimore në nivelin qendror dhe lokal si dhe të adresohen rekomandimet për përmirësimin e procesit mësimor. Për realizimin e këtij hulumtimi është përdorur instrumenti si pyetësorë i strukturuar për prindër dhe për nxënës.

Duke pasur parasysh situatën e pandemisë hulumtimi përkatësisht pyetësorët janë realizuar në formë online.

Pyetësorët janë dizajnuar në atë formë që të mbledhë informacione demografike, si dhe përmbajnë 13 pyetje për prindër dhe 13 pyetje për nxënës që marrin opinionet dhe pikëpamjet e tyre rreth sfidave me të cilat janë ballafaquar gjatë zhvillimit të mësimin në distancë/ virtual në periudhën mars-qershor 2020.

Me qëllim të përfshirjes së fëmijëve të grupit ROR dhe asambleve komunale të fëmijëve ata janë konsultuar dhe janë marrë opinionet dhe vendimet e tyre përgjatë tërë procesit të realizimit të hulumtimit.

Pjesëmarrës në këtë hulumtim ishin 159 prindër dhe 178 nxënës të shkollave fillore dhe të mesme të komunës së Prishtinës, Pejës, Prizrenit, Mitrovicës, Ferizajt, Gjilanit dhe Gjakovës. Përzgjedhja e shkollave brenda këtyre komunave është bërë me qëllim që të kemi një pasqyrë më të gjerë demografike duke synuar shkollat në qendër të komunës, në periferi dhe në fshat. Nga këto shkolla janë përfshirë në hulumtim prindërit dhe nxënësit e klasave që gjatë periudhës mars-qershor 2020 kanë qenë në klasat: 1, 3, 6, 9, 12.


Pjesëmarrësit janë informuar për qëllimin e hulumtimit, ndërsa për të mbrojtur konfidencialitetin e tyre, të gjitha të dhënat, përmes të cilave është supozuar se mund të identifikohen, janë larguar përgjatë procesit të përpunimit e të dhënave. Po ashtu prindërit janë pyetur për marrjen e aprovimit të tyre për pjesëmarrjen e fëmijëve të tyre në hulumtim.

Të dhënat e mbledhura përmes pyetësorëve në këtë hulumtim janë analizuar me anë të Programin Statistikor për Studime Sociale (SPSS) versionin 21.0.


Po ashtu janë analizuar materiale dhe raporte vendore dhe ndërkombëtare lidhur me ndikimin e pandemisë COVID-19 në procesin mësimor si dhe ju është referuar udhëzimeve që janë aktualisht zyrtare sa i përket procesit mësimor.

Analiza e te gjeturave dhe rezultateve nga pyetësorët e prindërve

Nga cila jeni?



Numri më i madh i pjesëmarrësve janë nga komuna e Ferizajt (36), 31 pjesëmarrës nga komuna e Prishtinës, 23 nga komuna e Gjakovës, 22 nga komuna e Pejës, nga Gjilani gjithsej 17 pjesëmarrës, 7 nga komuna e Prizrenit, 4 nga Mitrovica, nga 2 pjesëmarrës nga komunat: Leban, Rahovec, Skivjan dhe Zveçan, dhe 1 pjesëmarrës nga Besia.



Cili është profesioni i prindit?


Profesioni i prindërve

Nga 153 pjesëmarrës gjithsej, 97 prej tyre kanë raportuar se prindërit janë të punësuar, 53 prej tyre kanë thënë se janë të papunë, dhe ndërkafq 2 prej tyre raportojnë se jetojnë me asistencë sociale.

Viti shkollor i fëmijës

Të pyetur se në cilën klasë është aktualisht fëmija/fëmijët e tyre, prindërit (respondentët) janë përgjigjur si në vijim: Pjesa më e madhe e tyre, gjithsej 43 prindër e kanë fëmijën në klasën e 2-të fillore; 7 prindër kanë një nga fëmijët në klasën e 3-të të shkollës fillore; 34 prej tyre e kanë njërin fëmijë në klasën e 4-të fillore; 4

prindër raportojnë të kenë fëmijën në klasën e 5-të të shkollës fillore; vetëm 1 prind ka raportuar se ka njërin fëmijë në klasën e 6-të në shkollë fillore; 31 prindër e kanë një fëmijë në klasën e 7-të fillore; 3 prindër kanë fëmijën në klasën e 9-të të shkollës fillore; 18 prindër kanë fëmijë në klasën e 10-të apo vitin e parë të shkollës së mesme; dhe gjithsej 21 prindër raportojnë se kanë të paktën njërin prej fëmijëve në klasën e 11-të apo vitin e dytë të shkollës së mesme.




Gjinia e fëmijës suaj?

● Femër ● Mashkull

Sa i përket gjinisë së fëmijës, 89 prindër (58.2%) kanë raportuar se fëmija i tyre është i gjinisë femërore, dhe 64 prindër (41.8%) raportojnë se fëmija i tyre është i gjinisë mashkullore.

1. Sa mendoni se ishit të informuar për mësimin në distancë / virtual gjatë muajit mars-qershor 2020?




1. Sa mendoni se ishit të informuar për mësimin në distancë / virtual gjatë muajit mars-qershor 2020

Të pyetur se sa të informuar kanë qenë ata si prindër për mësimin në distancë/ virtual gjatë muajit mars-qershor 2020, shumica e prindërve (63), kanë raportuar se kanë qenë shumë mirë të informuar për mësimin në distancë; një numër i madh i prindërve (46) po ashtu kanë raportuar se kanë qenë mirë të informuar për mësimin në distancë; 38 prej tyre kanë raportuar për një informim mesatar lidhur me këtë çështje; 4 prindër kanë qenë pak të informuar për mësimin virtual; dhe vetëm 2 prindër kanë raportuar se nuk kanë qenë aspak të informuar për këtë lloj të mësimin.

Institucionet arsimore në Kosovë vazhdojnë të përdorin dhe bazohen në metodat tradicionale të të mësuarit, që do të thotë se ato ndjekin qasjen tradicionale të të ligjëruarit ballë për ballë në një klasë. Prandaj, në një situatë të tillë të re është detyrë e shkollës/ve të sigurohen se kanë burime të përshtatshme dhe me cilësi të lartë. Po ashtu, shkolla duhet të jetë burimi kryesor i informacionit për prindërit në lidhje me ecurinë e procesit mësimor të fëmijëve të tyre. Përmes informimit dhe mbështetjes së duhur, bëhet e mundur që edhe përmes prindërve si facilitatorë, të gjithë nxënësve t'u jepen mundësi të barabarta për të mësuar dhe për të arritur sukses në shkollë.

2. Sa mendoni se kishit shkathtësitë e duhura për të përdorur teknologjinë e duhur për t'i ndihmuar fëmijës suaj në mësim?



2. Sa mendoni se kishit shkathtësitë e duhura për të përdorur teknologjinë e duhur për t'i ndihmuar fëmijës suaj në mësim?


Pjesa më e madhe e prindërve (79), janë përgjigjur se kanë pasur shkathtësi shumë të mira për të përdorur teknologjinë për t'i ndihmuar fëmijës në mësim; 54 prej tyre kanë raportuar se kanë pasur shkathtësi të mira lidhur me aftësitë për të përdorur teknologjinë e duhur; 15 prindër kanë thënë se shkathtësitë e tyre ishin mesatare në përpjekje për të përdorur teknologjinë; dhe 5 prej tyre mendojnë se kanë pasur pak shkathtësi për të përdorur teknologjinë e duhur për t'i ndihmuar fëmijës/fëmijëve gjatë mësimit virtual.

Kompetenca digjitale e prindërve ka qenë një nga determinuesit kryesor në suksesin akademik të fëmijëve në këtë periudhë. Prindërit është dashur të mësojnë paralelisht me fëmijët e tyre dhe t'u gjinden në çdo hap gjatë mësimit online. Normalisht që kjo përgjegjësi e shtuar dhe frika nga e panjohura, përveç ngarkesës fizike dhe psikologjike, ka shkaktuar edhe një dozë ankthi tek prindërit që me vetëdije apo jo është përcjellë edhe tek fëmijët.

3. Prej nga i keni marrë informacionet rreth procesit të mësimit në distancë/virtual?

Të pyetur se nga i kanë marrë informacionet rreth procesit mësimor në distancë, numri më i madh i prindërve (101), kanë raportuar për mediat si burimin kryesor të informatave lidhur me mësimin në distancë; tutje, 86 prindër kanë zgjedhur shkollën si institucionin informues lidhur me mësimin virtual; 71 prindër kanë përzgjedhur Ministrinë e Arsimit; dhe 40 prindër kanë thënë e përveç burimeve të lartpërmendura, informacione lidhur me procesin e mësimit në distancë kanë marrë edhe nga vet fëmija/fëmijët e tyre.







4. Sa ishte e vështirë për fëmijën tuaj zhvillimi i mësimit në distancë/ virtuale

Lidhur me këtë pyetje, 82 prindër janë shprehur se fëmija i tyre e ka pasur disi të vështirë zhvillimin në distancë; 34 kanë raportuar se nuk e ka pasur aspak të vështirë; 19 prindër thonë se fëmija i tyre e ka pasur të vështirë; 17 raportojnë se e fëmija/fëmijët e kanë pasur shumë të vështirë; dhe vetëm 1 prind raporton se nuk e di nivelin e vështirësisë me të cilin është përballur fëmijën i tij lidhur me mësimin virtual.


Siç edhe do shihet nga rezultatet në pyetjet e mëposhtme, prindërit kanë cilësuar se niveli i vështirësisë së fëmijëve është varur edhe nga qasja në internet dhe posedimi i pajisjeve teknologjike. Si rezultat i pabarazisë në statusin socio-ekonomik mes familjeve në Kosovë dhe rrjedhimisht nxënësve, shumica prej tyre mbështeten në librat apo mjetet që ndan shkolla në fillim të vitit akademik, dhe për shkak të mbylljes së shkollave, procesi i integritit të këtyre grupeve të nxënësve pritet të jetë më i ngadaltë, dhe paralelisht edhe niveli i vështirësisë rritet.

5. A kishte qasje në internet fëmija juaj?



130 prindër kanë raportuar se fëmija i tyre ka pasur qasje në internet; 15 janë shprehur se fëmija i tyre ka pasur ndonjëherë qasje në internet; 6 kanë thënë se fëmija është qasur me vështirësi në internet; dhe vetëm 2 prindër kanë raportuar se fëmijët e tyre nuk ka pasur qasje në internet.


6. A i kishit pajisjet e duhura fëmija juaj për mësim në distancë / virtual?




6. A i kishit pajisjet e duhura fëmija juaj për mësim në distancë / virtual?

- Aspak të pajisur
- Mirë të pajisur
- Disi të pajisur
- Shumë mirë i/e pajisur

Pjesa më e madhe e prindërve (75), janë shprehur se fëmija i tyre ka qenë shumë mirë i pajisur për mësimin në distancë; 51 prindër mendojnë se fëmija i tyre ka qenë mirë i pajisur; 26 raportojnë se fëmija ka qenë disi i pajisur; dhe vetëm 1 prind ka thënë se fëmija i tij nuk ka qenë aspak i pajisur.



7. Sipas jush sa keni arritur ta ndihmoni fëmijën tuaj gjatë mësimit në distancë / virtual?



7. Sipas jush sa keni arritur ta ndihmoni fëmijën tuaj gjatë mësimit në distancë / virtual?

Lidhur me pyetjen se sa kanë arritur prindërit të jenë ndihmesë për fëmijët e tyre gjatë mësimit virtual, shumica e prindërve (97) kanë raportuar se kanë arritur ta ndihmojnë fëmijën e tyre gjatë gjithë kohës; 38 prej tyre raportojnë se ndonjëherë kanë arritur ta ndihmojnë fëmijën për mësimin virtual; 9

prindër mendojnë se kanë arritur shumë pak ta ndihmojnë fëmijën e tyre; dhe 9 prindër kanë dhënë përgjigje tjera lidhur me ndihmën e ofruar, duke përfshirë (janë ndihmuar nga fëmijët më të mëdhenj, fëmija nuk ka pasur mësime virtuale etj.).

8. Sipas jush cilat ishin problemet/ vështirësitë kryesore që kishte fëmija juaj gjatë mësimit në distancë/ virtual?

Në këtë pyetje janë elaboruar gjerësisht problemet apo vështirësitë kryesore që kishin fëmijët gjatë mësimit virtual. Rreth 45 prindër kanë raportuar se fëmijët e tyre nuk kanë pasur asnjë vështirësi gjatë mësimit në distancë/virtual. Ndërkaq, pjesa tjetër e prindërve kanë cilësuar vështirësi të ndryshme me të cilat janë përballur fëmijët e tyre, të cilat do t'i shqyrtojmë në vijim:

- Mungesa e qartësisht të detyrave
- Probleme me ndaljen e rrymës
- Problemet teknike me rrjetin
- Përshtatja me platformën Zoom
- Vështirësi koncentrimi pasi që në familje kishe shumë anëtarë
- Angazhim i tepruar
- Detyra të shumta të shtëpisë
- Koncentrimi shumë i ulët
- Kohëzgjatje e shkurtër e mësimit

Vështirësi në kuptimin e mësimit
Vështirësi në zhvillimin e detyrave të matematikës
Rezultatet janë tejet interesante për faktin se mendimet dhe përgjigjet e prindërve rezultojnë pothuajse identike me përgjigjet dhe vlerësimet që kanë dhënë vetë fëmijët. Kjo lë të nënkuptojë që ekziston një dakordim dhe vetëdije kolektive mbi mënyrën se si ka shkuar procesi i mësimit online.

Një tjetër arsye pse këto rezultate të përputhshme kanë një konotacion pozitiv, është për faktin se përmes këtyre të dhënave kuptojmë që prindërit kanë qenë pjesë aktive gjatë procesit mësuesor dhe kanë punuar së bashku me fëmijët e tyre.

9. Si prind, çfarë ju duhet të dini më shumë në mënyrë që ta ndihmoni fëmijën tuaj për mësime në distancë/ virtual?

Në këtë pjesë prindërit u ftuan të tregonin për nevojat e tyre për të ndihmuar më tepër fëmijët në mësimin virtual.

Përgjigjet më të shpeshta janë përmbledhur si në vijim:

- Takime më të shpeshta prindër-

- mësimdhënës
- Sqarime më të detajuara për detyrat
- Orar më i saktë dhe i koordinuar nga ana e mësimdhënësve
- Udhëzime të hollësishme për përdorimin e teknologjisë

10. Çka do të sugjeronit të ndërmarrë shkolla apo Ministria e Arsimit që mësimi në distancë/ virtual të jetë më i lehtë dhe më i suksesshëm për fëmijën tuaj?

Vetëm një numër i vogël i prindërve pjesëmarrës u përgjigjën që nuk kishte nevojë për ndonjë ndryshim dhe se gjithçka kishte shkuar në rregull. Ndërkaq, e gjithë pjesa tjetër kanë dhënë sugjerimet e tyre lidhur me atë se çfarë duhet intervenuar në mënyrë që mësimi në distancë të jetë më i suksesshëm. Përgjigjet më të shpeshta janë përmbledhur si në vijim:

- Angazhim më i madh i mësimitdhënësve
- Dhurim i pajisjeve teknologjike për ata që nuk kanë kushte ekonomike
- Një orar i saktë dhe i pandryshueshëm
- Mësimi përmes TV të zgjasë më shumë
- Të transmetohen të gjitha lëndët dhe t'u kushtohet e njëjta rëndësi

- Shpjegime më të qarta nga mësimitdhënësit
- Të aplikohet mësimi i kombinuar
- Të mbahet mësim shtesë për nxënësit të cilët kanë rezultate më të ulëta
- Të punojnë të gjithë mësimitdhënësit me të njëjtën platformë
- Të kyçen të gjithë mësimitdhënësit dhe të jenë të rregullt në mësim
- Të vazhdojë mësimi në ambientet e shkollës
- Të sigurohen mjetet mbrojtëse (maskat, dorëzat dhe dezinfektuesit) për të gjithë nxënësit, që mësimi në shkollë të jetë i sigurtë.

11. Sipas jush, nëse vazhdon situata me pandemi, si duhet të vazhdojë procesi mësimor?

Sa i përket vazhdimit të procesit mësimor, 21 prindër mendojnë se mësimi duhet vazhduar përmes Televizionit; 59 mendojnë se mësimi duhet të vazhdojë përmes mësimit virtual në platforma të ndryshme; 43 prindër janë të mendimit se mësimi duhet të vazhdojë të jetë i kombinuar (përmes TV dhe platformave online); dhe pjesa më e madhe e tyre (69), raportojnë se mësimi duhet të zhvillohet në ambientet e shkollës.

12. A keni pasur pakënaqësi për mësimin virtual, nëse po ku jeni ankuar dhe a keni marrë përgjigje?


Lidhur me pakënaqësitë mbi mësimin virtual, 100 prindër kanë raportuar se nuk kanë pasur pakënaqësi dhe si rrjedhojë nuk janë ankuar. Ndërkaq, pjesa tjetër kanë shprehur se kanë pasur pakënaqësi. Shumica prej tyre janë ankuar tek mësuesja përkatëse, disa kanë marrë përgjigje, disa jo. Tjerë janë ankuar në Drejtoritë Komunale të Arsimit (DKA), por pa nuk kanë marrë përgjigje për ankesat dhe pakënaqësitë e tyre.

13. Komente/ sugjerime tjera

Në këtë pjesë shumica e prindërve pjesëmarrës në hulumtim, e kanë shfrytëzuar për t'i falënderuar mësime të cilat e kanë kryer punën me përpikëri. Të tjerë janë shprehur se do dëshironin që mësimi të vazhdonte në ambientet e shkollës dhe jo virtualisht. Njëri nga prindërit ka theksuar se është mirë të zhvillohet për të gjitha shkollat e Kosovës, një CMS moodle.org dhe aty të vendosen të gjitha materialet për mësim dhe zgjidhje detyrash. Të tjerë prindër sugjerojnë që fëmijëve të mos u vihen mungesa në qoftë se ata nuk kyçen në mësim për shkak të probleme me rrymë apo me rrjetin. Një tjetër sugjerim është që të merren shembuj mësime të cilat e kanë kryer punën me përpikëri dhe të vlerësohet e shpërblehet puna e tyre nga DKA dhe MASH dhe puna e tyre të merret shembull.

Nga cila komunë jeni?


- | | |
|-----------|-------------|
| ● Bec | ● Mitrovicë |
| ● Besi | ● Pejë |
| ● Ferizaj | ● Prishtinë |
| ● Gjakovë | ● Prizren |
| ● Gjakovë | ● Rimanisht |
| ● Gjilan | ● Skivjan |
| ● Leban | ● Zveçan |




Numri më i madh i fëmijëve pjesëmarrësve janë nga komuna e Prishtinës (38), 35 pjesëmarrës nga komuna e Ferizajt, 32 nga komuna e Gjakovës, 30 nga komuna e Pejës, nga Gjilani gjithsej 17 pjesëmarrës, 7 nga komuna e Prizrenit, 5 nga Mitrovica, 3 pjesëmarrës nga Skivjani, 2 pjesëmarrës nga komuna e Zveçanit, dhe nga 1 fëmijë pjesëmarrës nga komunat: Leban, Rimanisht, Besi dhe Bec.

Niveli aktual i shkollimit

Numri më i madh i fëmijëve pjesëmarrësve janë nga komuna e Prishtinës (38), 35 pjesëmarrës nga komuna e Ferizajt, 32 nga komuna e Gjakovës, 30 nga komuna e Pejës, nga Gjilani gjithsej 17 pjesëmarrës, 7 nga komuna e Prizrenit, 5 nga Mitrovica, 3 pjesëmarrës nga Skivjani, 2 pjesëmarrës nga komuna e Zveçanit, dhe nga 1 fëmijë pjesëmarrës nga komunat: Leban, Rimanisht, Besi dhe Bec.



Në cilën klasë jeni momentalisht



1. Ake vijuar rregullisht mësimin në distancë / Virtuale?

● Po
 ● Jo
 ● Ndonjëherë
 ● Me vështirësi
 ● Nuk e di

Të pyetur se në cilën klasë janë aktualisht, fëmijët (respondentët) janë përgjigjur si në vijim: Vetëm një nxënës është në klasën e 1-rë; pjesa më e madhe e tyre, gjithsej 50 fëmijë janë në klasën e 2-të fillore; 4 fëmijë janë në klasën e 3-të të shkollës fillore; 35 prej tyre vijnë në klasën e 4-të; 4 fëmijë janë nxënës në klasën e 5-të; 29 nxënës janë në klasën e 7-të fillore; 2 fëmijë vijnë në klasën e 8-të; vetëm një fëmijë është nxënës në klasën e 9-të të shkollës fillore; 23 vijnë në klasën e 10-të apo vitin e parë të shkollës së mesme; dhe gjithsej 25 nxënës që janë në

klasën e 11-të apo vitin e dytë të shkollës së mesme.

Me përjashtim të klasës së 6-të të shkollës fillore dhe klasës së 12-të të shkollës së mesme, të gjitha klasat e tjera janë të përfshira në studim, që i jep një vlerë të shtuar këtij hulumtimi duke qenë se jep një pasqyrë tejet reprezentative dhe gjithëpërfshirëse mbi procesin mësimor në distancë/virtual, gjatë periudhës së pandemisë.

Të pyetur nëse e kanë vijuar rregullisht mësimin në distancë/ virtual, numri më i madh i fëmijëve (156), ka raportuar se po i ka ndjekur mësimet virtuale rregullisht. Një pjesë tjetër (9), raporton se i ka ndjekur mësimet ndonjëherë; 7 fëmijë i kanë ndjekur mësimet virtuale me vështirësi; dhe vetëm 1 fëmijë nuk i ka ndjekur rregullisht mësimet e mbajtura në distancë apo virtualisht.

Sfida më e madhe e të mësuarit në distancë/ virtual ka të bëjë kryesisht me menaxhimin e kohës dhe teknologjisë. Për nxënësit që janë të prirur për zvarritje akademike, të mësuarit në internet mund të jetë e vështirë për tu koordinuar dhe motivimi për të vijuar

rregullisht mësimin mund të jetë një sfidë në vete. Meqenëse shumica e të mësuarit në distancë varet nga aftësia e një nxënësi për t'i dhënë vetë drejtimin mësimi, nxënësit që janë mësuar me ndjekjen e udhëzimeve dhe orientimin nga një supervisor (mësimdhënësi/ja), mund të jenë më të prirur për të pasur motivim, pjesëmarrje dhe performancë më të ulët akademike. Ndërkaq, për ata nxënës që kanë përkushtimin dhe motivimin për t'iu përshtatur të mësuarit në distancë/virtual, ata mund të kenë një lloj përparësie por prapë mund të kenë pengesa tjera, të cilat do shqyrtohen në pyetjet në vazhdim.


Nëse nuk e ke vijuar mësimin virtual, cilat ishin arsytet?

Duke qenë se numri më i madh i fëmijëve pjesëmarrës e kanë vijuar mësimin virtual, pjesa tjetër ka deklaruar që ka qenë e vështirë për shkak të problemeve teknike me rrymën dhe internetin; mësuesja nuk ka mbajtur mësim online por vetëm ka dërguar detyra të shtëpisë, orari ka qenë i papërshtatshëm, mësimi është mbajtur në mënyrë të çrregullt, si dhe problem kryesor ka qenë mungesa e pajisjeve teknologjike.

Këto rezultate janë në përputhje me rezultatet e shumicës së hulumtimeve të organizuara në vende të ndryshme të botës, dhe në sisteme të ndryshme edukativo-arsimore. Të mësuarit në distancë/virtual në tërësinë e tij varet nga pajisjet teknologjike dhe interneti, Mësimdhënësit dhe nxënësit me mungesë të mjeteve teknologjike të nevojshme për mësim dhe me lidhje të dobët


në internet, mund të kenë pësuar gjatë këtij procesi mësimor. Varësia e të mësuarit në internet nga pajisjet teknologjike dhe sigurimi i pajisjeve ishte një sfidë e madhe jo vetëm për fëmijët dhe prindërit e tyre, por edhe për institucionet në vend. Sfida për institucionet arsimore nuk është vetëm gjetja e pajisjeve teknologjike dhe përdorimi i saj por edhe rindërtimi i imazhit të arsimit, duke ndihmuar kështu nxënësit, prindërit dhe stafin akademik që kërkojnë udhëzime mbi njohuritë dhe zotërimin digjital.

3. Sipas jush mësimi në distancës/ virtual ka qenë i organizuar?




3. Sipas jush mësimi në distancë / virtual ka qenë i organizuar?

Pjesa më e madhe e fëmijëve (69), kanë raportuar se mësimi virtual ka qenë mirë i organizuar; një pjesë tjetër (59) mendon se mësimi në distancë ka qenë shumë mirë i organizuar; 41 prej tyre raporton se mësimi ka qenë mesatarisht i organizuar; dhe 5 fëmijë kanë dhënë mendimin se mësimi në distancë nuk ka qenë aspak i organizuar.



4. A ishin të kuptueshme detyrat e shtëpisë?



4. A ishin të kuptueshme detyrat e shtëpisë

Duke qenë se numri më i madh i fëmijëve pjesëmarrës e kanë vijuar mësimin virtual, pjesa tjetër ka deklaruar që ka qenë e vështirë për shkak të problemeve teknike me rrymën dhe internetin; mësuesja nuk ka mbajtur mësim online por vetëm ka dërguar detyra të shtëpisë, orari ka qenë i papërshtatshëm, mësimi është mbajtur në mënyrë të çrregullt, si dhe problem kryesor ka qenë mungesa e pajisjeve teknologjike.

Këto rezultate janë në përputhje me rezultatet e shumicës së hulumtimeve të organizuara në vende të ndryshme të botës, dhe në sisteme të ndryshme edukativo-arsimore. Të mësuarit në distancë/virtual në

tërësinë e tij varet nga pajisjet teknologjike dhe interneti, Mësimdhënësit dhe nxënësit me mungesë të mjeteve teknologjike të nevojshme për mësim dhe me lidhje të dobët në internet, mund të kenë pësuar gjatë këtij procesi mësimor. Varësia e të mësuarit në internet nga pajisjet teknologjike dhe sigurimi i pajisjeve ishte një sfidë e madhe jo vetëm për fëmijët dhe prindërit e tyre, por edhe për institucionet në vend. Sfida për institucionet arsimore nuk është vetëm gjetja e pajisjeve teknologjike dhe përdorimi i saj por edhe rindërtimi i imazhit të arsimit, duke ndihmuar kështu nxënësit, prindërit dhe stafin akademik që kërkojnë udhëzime mbi njohuritë dhe zotërimin digjital.

Në pyetjen se a ishin të kuptueshme detyrat e shtëpisë që janë dhënë gjatë mësimit në distancë, vetëm njëri (1) nga fëmijët ka thënë se detyrat nuk ishin aspak të kuptueshme; 3 fëmijë janë përgjigjur se detyrat kanë qenë pak të kuptueshme; 37 janë shprehur se detyrat ishin mesatarisht të kuptueshme; një pjesë tjetër e


fëmijëve (55) kanë raportuar se detyrat kanë qenë mirë të kuptueshme; dhe pjesa më e madhe e fëmijëve pjesëmarrës (78) ka deklaruar se detyrat e shtëpisë kanë qenë shumë të kuptueshme.

5. Nëse ke pasur nevojë për ndihmë në detyrat e shtëpisë, kush të ka ndihmuar?


Shumica e fëmijëve kanë raportuar se kanë pasur burime të shumëfishta të ndihmës sa i përket detyrave të shtëpisë. Në vijim do raportojmë për një përmbledhje të burimeve të ndihmës të raportuara nga fëmijët. Një numër i madh i fëmijëve (115), i ka konsideruar prindërit si ndihmë primare për detyrat e shtëpisë; 73 fëmijë kanë marrë ndihmë nga mësimdhënësi/ja; 35 fëmijë kanë marrë ndihmë shtesë edhe nga shokët dhe shoqet e klasës; 26 fëmijë kanë pasur ndihmë për detyra edhe nga anëtarët e tjerë të familjes; 18 fëmijë kanë raportuar se nuk kanë pasur nevojë për ndihmë; dhe edhe pse një numër i vogël, prapë fatkeqësisht 4 fëmijë kanë raportuar se nuk kanë marrë ndihmë nga askush në lidhje me detyrat e shtëpisë.

Rezultatet qartazi tregojnë nevojën e madhe që kanë pasur fëmijët në lidhje me detyrat e shtëpisë; për më tepër që kanë pasur nevojë për burime të shumëfishta të ndihmës. Një nga problemet kyçe që është vënë në pah

gjatë mbajtjes së mësimit online në periudhën e pandemisë, ka qenë mbingarkesa e nxënësve me detyra të shtëpisë. Kjo mbingarkesë ka rritur nivelet e stresit dhe të ankthit tek nxënësit, e cila mund të rezultojë në probleme të shëndetit mendor, dhe si rrjedhojë, në rënie të performancës akademike.



6. Sipas jush a kanë qenë mësime dhënë e përgatitur për mësimin në distancë/virtual?




4. A ishin të kuptueshme detyrat e shtëpisë

Lidhur me përgatitjen e mësime dhënë për mësimin në distancë, 4 fëmijë janë shprehur se mësime dhënë nuk kanë qenë aspak të përgatitur për mësimin virtual; 5 kanë thënë se kanë qenë pak të përgatitur; 23 fëmijë janë përgjigjur se mësime dhënë kanë qenë mesatarisht të përgatitur për mësimin në distancë; tutje, 50 fëmijë raportojnë se mësime dhënë kanë qenë mirë të përgatitur; dhe pjesa më e madhe (92), mendojnë se mësime dhënë kanë qenë shumë mirë të përgatitur.

Duke qenë se në Kosovë i gjithë sistemi edukativo-arsimor mbështetet në literaturë tekstuale, dhe përfshin shumë pak inkuadrin e pjesës teknologjike, kjo krizë

pandemie ka ekspozuar shumë pamjaftueshmëri dhe nevojën për ndryshim në sistemin tonë arsimor. Kapaciteti i mësuesve për të përdorur teknologjinë ka qenë boshti në të cilin është mbështetur dhe varur i gjithë sukcesi apo dështimi i procesit të mësimit në distancë dhe virtual. Kompetenca digjitale e mësime dhënëve dallon shumë duke marrë parasysh nivelin e edukimit, moshën dhe zonën urbane apo rurale ku jep mësime, prandaj edhe përgatitja e tyre varion dhe kjo u ka dhënë mundësinë nxënësve që të bëjnë diferencën dhe vlerësimin mbi kompetencën e tyre, siç edhe është shprehur në rezultatet e mësipërme.



7. A ka qenë reale mënyra e vlerësimit tuaj përmes mësimit në distancë / virtuale?

- Po
- Ndonjëherë
- Jo
- Me vështirësi
- Nuk e di

Lidhur me këtë pyetje, pjesa më e madhe e fëmijëve pjesëmarrës (133), shprehen se realisht nuk e dinë nëse mënyra se si janë vlerësuar për këtë periudhë akademike ka qenë reale; 21 fëmijë mendojnë se kjo mënyrë vlerësimi ndonjëherë ka qenë reale; 12 raportojnë se mënyra e vlerësimit nuk ka qenë aspak reale; 7 mendojnë se po ka qenë reale mënyra e vlerësimit; dhe një (1) fëmijë mendon se jo nuk ka qenë reale mënyra e vlerësimit.

Mënyra e vlerësimit ka qenë një ndër polemikat më të diskutuara sa i përket mësimit në distancë. Në të mësuarit virtual, vlerësimet shpesh kryhen në internet përmes të cilave mësimeve janë të

kufizuar në mbikëqyrjen e nxënësve, duke e bërë të pamundur rregullimin dhe kontrollimin e mashtrimit gjatë procesit të testimit. Për më tepër, që nxënës të ndryshëm performojnë më mirë varësisht mënyrës së vlerësimit që u shkon më përshpirti atyre, dhe kjo mënyrë e testimit e ka pamundësuar këtë, duke krijuar vlerësime që ndoshta nuk janë as reale e as të drejta sipas perceptimit të vetë fëmijëve pjesëmarrës.

8. Çka të ka pëlqyer më së shumti nga mësimi në distancë/ virtual?

Në këtë pjesë, fëmijët janë ftuar të elaborojnë në mënyrë të hapur për gjërat që ju kanë pëlqyer më së shumti nga mësimi në distancë/virtual. Në vijim janë përmbledhur përgjigjet më të shpeshta, si:

Ambienti në shtëpi ka qenë më i qetë se në klasë

Kemi kaluar më shumë kohë me familje

Ka qenë interesante komunikimi me platforma të ndryshme virtuale


Përvetësim i teknologjisë

Ka qenë përparësi fakti që mësimet që janë dhënë në RTK kanë qenë edhe në Youtube, dhe kemi mundur t'i rishikojmë sa herë kemi pasur nevojë.

Lëndët mësimore kanë qenë më të lehta për t'u mësuar

Mësimi ishte me orar më të shkurtër dhe kemi pasur më shumë kohë të lirë

Vlen të ceket, që një pjesë e konsiderueshme e fëmijëve kanë shprehur se nuk ju ka pëlqyer aspak mësimi në distancë/virtual por vetëm ka qenë një domosdoshmëri.




9. Sipas jush sa e vlerësoni se keni mësuar gjëra të reja gjatë mbajtjes së mësimit në distancë/ virtual?

Fëmijëve u është kërkuar të japin një vlerësim lidhur me atë se sa mendojnë se kanë mësuar gjëra të reja gjatë mësimit në distancë. 3 fëmijë kanë raportuar se nuk kanë mësuar aspak gjëra të reja gjatë mësimit virtual; numri më i madh i fëmijëve pjesëmarrës (79) ka konsideruar se mesatarisht kanë mësuar gjëra të reja; 23 prej tyre mendojnë se kanë mësuar pak; dhe 69 fëmijë raportojnë se kanë mësuar shumë gjëra të reja gjatë mësimit virtual.

Për shumicën e fëmijëve apo nxënësve pjesëmarrës, edhe bazat e të mësuarit nuk kanë qenë të disponueshme në ambientet e shtëpisë. Kjo për arsye edhe të

ndërhyrjeve që mund të kenë ardhur nga pjesëtarët tjerë të familjes gjatë orarit mësimor. Ndërhyrja e anëtarëve të familjes, mund të ketë shkaktuar devijim ose shpërqendrim të vëmendjes tek fëmijët në mësimin në distancë gjatë procesit të mësimit, dhe kjo ka qenë një sfidë plus për fëmijët për të qenë në gjendje të kuptojnë mësimet.

Shtuar faktit edhe që, shumica e mësimit në kushtet e krijuara nuk kanë arritur të përmbushin objektivat e lëndës siç do kishin bërë në ambientet e shkollës, kjo gjë që ka sjellë mungesën e vëmendjes dhe vullnetit të fëmijëve për të mësuar gjëra të reja gjatë kësaj periudhe.



10. A do donit të ndryshonit diçka në mënyrën e mësimit në distancë/virtual?

Qëllimi i kësaj pyetje ka qenë identifikimi i praktikave që nuk kanë qenë efektive gjatë mësimit në distancë, dhe mendimet e nxënësve se çfarë do duhej të bëhej më mirë. Ndërsa vetëm një numër i vogël i fëmijëve pjesëmarrës kanë raportuar se gjithçka ka qenë në rregull, pjesa më e madhe e fëmijëve kanë dhënë sugjerime mbi ndryshimet e nevojshme për përmirësimin e mësimit në distancë. Raportimet e tyre janë përmbledhur si në vijim:

- Mësimdhënësit të jenë më të përgatitur
- Detyrat e shtëpisë të jenë më të qarta
- Të ketë më pak detyra

- Kohëzgjatja e orëve mësimore të jetë më e gjatë
- Kohëzgjatja në TV të jetë më e gjatë
- Të ketë mundësi komunikimi me nxënësit e tjerë të klasës
- Orari të jetë më i përshtatshëm
- T'i jepet mundësia secilit nxënës të flasë
- Të ketë aktivitete brenda orës që janë më atraktive
- Mësimi të zhvillohet vetëm në një platformë
- Të respektohet dhe të ndiqet plan programi, jo të shpjegohen gjërat e njëjta

11. A keni pasur pakënaqësi për mësimin virtual, nëse po ku jeni ankuar dhe a keni marrë përgjigje?

Nxënësit pjesëmarrës gjithashtu kanë treguar mbi pakënaqësitë e tyre dhe nëse kanë paraqitur ankesa lidhur me mësimin virtual. Një pjesë e tyre kanë raportuar se nuk kanë pasur pakënaqësi dhe as nuk janë ankuar. Ndërkaq, pjesa tjetër ka pasur dhe ka raportuar pakënaqësitë e ndryshme që kanë pasur.

Gati të gjithë fëmijët pjesëmarrës raportojnë se janë ankuar tek kujdestari/ja e klasës, ose mësimdhënësit e tjerë por nuk kanë marrë përgjigje nga asnjëri prej tyre.

Të dhënat e nxjerra nga kjo pyetje, na lë të nënkuptojmë që fëmijët janë plotësisht të vetëdijshëm për gjërat që nuk kanë shkuar siç duhet gjatë mësimin virtual dhe në distancë. Për më tepër, ata dëshmojnë edhe për marrjen e iniciativës për ndryshim, duke kërkuar përgjigje mbi pakënaqësitë e tyre. Besojmë se hapi i parë që duhet të ndërmerret për përmirësimin e mëtutjeshëm të procesit mësimor, është marrja në konsideratë e ankesave dhe pakënaqësive të fëmijëve, dhe bashkëpunimi me ta për të arritur në rezultate sa më të kënaqshme për të gjitha palët.

12. Sipas jush, nëse vazhdon situata me pandemi, si duhet të vazhdojë procesi mësimor?

Sa i përket vazhdimit të procesit mësimor, 20 fëmijë mendojnë se mësimi duhet vazhduar përmes Televizionit; 58 mendojnë se mësimi duhet të vazhdojë përmes mësimin virtual në platforma të ndryshme; 47 fëmijë janë të mendimit se mësimi duhet të vazhdojë të jetë i kombinuar (përmes TV dhe platformave online); një pjesë tjetër (58), raportojnë se mësimi duhet të zhvillohet në ambientet e shkollës; dhe 12 fëmijë raportojnë se nuk e dinë se si duhet vazhduar procesi mësimor nëse vazhdon situata me pandemi.

Rezultatet e mësipërme tregojnë për një ambivalencë të fëmijëve lidhur me vazhdimësinë e procesit mësimor në vitin e ri akademik. Kjo pavendosmëri jep indikacione se sa shumë konfuzitet ka shkaktuar tek fëmijët kjo llojllojshmëri e mbajtjes së procesit mësimor. Siç vihet re edhe nga rezultatet e shpërndara, sipas fëmijëve asnjëra mënyrë e mbajtjes së mësimin nuk ka qenë e arrirë dhe nuk ka mundur të përmbushë plotësisht kërkesat e tyre lidhur me procesin mësimor.

13. Komente/ sugjerime tjera?

Në këtë pjesë, njëjtë sikurse edhe pjesëmarrësit prindër, shumica e fëmijëve pjesëmarrës në hulumtim, e kanë shfrytëzuar për t'i falënderuar mësimitdhënësit të cilët e kanë kryer punën me përpikëri. Të tjerë janë shprehur se do dëshironin që kjo situatë të mos përsëritet më dhe mësimi të vazhdonte normalisht në ambientet e shkollës dhe jo në distancë apo në mënyrë virtuale.

Një nga arsyet kyçe sipas psikologëve përse fëmijët shpresojnë dhe anojnë më shumë nga mësimi në mënyrë fizikë në ambientet e shkollës, ka të bëjë edhe me pjesën e socializimit dhe interaksionit. Të mësuarit në distancë apo përmes internetit, humbet tërheqjen dhe zbeh interesin për nxënësit që janë të dhënë pas përvojave tradicionale që ofron ambient i shkollës.

